Kronikë

Durrës/ Gjendet lëndë plasëse në hyrje të ish-hotelit të vëllait të ish-kryebashkiakut Vangjush Dako, bëhet shpërthim i kontrolluar (VIDEO)

Menjëherë pasi është njoftuar për qesen e dyshimtë, policia ka mbërritur në vendin e ngjarjes, ku ka rrethuar zonën dhe ka bërë evakuimin e banorëve aty pranë. Po ashtu, në vendin e ngjarjes kanë mbërritur menjëherë edhe forcat xheniere të cilat kanë asgjësuar lëndën plasëse me shpërthim të kontrolluar.

[Sh].com Redaksia
13 Shtator, 20:37 | **Përditësimi: 13 Shtator, 21:49**

Share

DURRËS - Një sasi e vogël lëndë plasëse, e vendosur brenda në një qeseje, është konstatuar mbrëmjen e sotme nga banorët e lagjes nr.1, në hyrje të ish-hotelit "Pameba" në pronësi të Edmond Dakos, vëllait të ish-kryebashkiakut të Durrësit, Vangjush Dako.

Menjëherë pasi është njoftuar për qesen e dyshimtë, policia ka mbërritur në vendin e ngjarjes, ku ka rrethuar zonën dhe ka bërë evakuimin e banorëve aty pranë.

Po ashtu, në vendin e ngjarjes kanë mbërritur menjëherë edhe forcat xheniere të cilat kanë asgjësuar lëndën plasëse me shpërthim të kontrolluar.

[Sh].com

LEXO EDHE:
Durrës/ Kinezja 57-vjeçare vdes në një taksi pranë 'Urës së Dajlanit', dyshohet se pësoi arrest kardiak

> *"Në lagjen nr. 1, Durrës, në hyrje të një ndërtese (ish-hotel, jashtë funksionit), në një nga vazot e luleve është gjetur një sasi e dyshuar lëndë plasëse, dyshohet artizanale. Grupi hetimor, në bashkëpunim me Njësinë Antieksplozivë të RENEA-s, po kryen veprimet për sqarimin e rrethanave, përcaktimin e llojit të lëndës së gjetur, si dhe identifikimin dhe kapjen e autorit/ve",- lajmëron policia.*

Fatmirësisht nuk raportohet për të lënduar shpërthimi dhe as dëme materiale në zonën përreth, pasi bëhet fjalë për një zonë të populluar. Disa vite më parë, hoteli ka qenë përdorur edhe nga forcat e Guardia di Finanza kur ishin me mision në Durrës.

Kujtojmë se më 20 maj të këtij viti një ngjarje e ngjashme ndodhi rreth 50 metra distancë nga **banesa e ish-kryebashkiakut Dako** në Durrës, ku u gjet 70 gramë eksploziv, e lënë në rrugë nga persona edhe sot ende të paidentifikuar dhe në rrethana të paqarta.

K.M/Shqiptarja.com

TAG: hotel Edmond Dako vangjush dako Durres lende plasese

Komento

Komente

Lala: 14/09/2025 09:36
Tani Ose gazetari ja fut me shpulla Ose ATA QE kan ber asgjesimin me shperthim te kontrolluar kan ber k..llik te modh.me SA di un SI I zanatit nuk asgjesohet eksplozivi me shperthim "e kontrollua" se nuk e kontrollon dot.e ta besh Aty ne vend? Hahahah.eksplozivi digjet ne menyre de te mo's shkaktoj detonim.nejse reklam te bukur inpaskeni bere hahah
Përgjigju

halle esmaja: 14/09/2025 00:51
HERES tjeter plaseni shpejt,,, te mos kete kohe per zbulim....
Përgjigju

Ndalohet reptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM
Sondazhi i ditës:
Sa të sigurt ndiheni nga mashtrimet online?
14 Shtator, 14:32
Shumë Pak Aspak

Lajme të tjera

Ndahet nga jeta në moshën 57-vjeçare Ajet Avdullaj, njeriu i modës në Durrës
Artur Korriku
13 Shtator, 11:48

'Tapë' në timon/ 55-vjeçari tenton të korruptojë punonjësit e policisë në Durrës, vihet në pranga (VIDEO)
13 Shtator, 11:26

MEKI, marrëveshje bashkëpunimi me Porti MBM për restaurimin e 'Muret e Portës'! Gonxhja: Hap i rëndësishëm për të shpëtuar pasurinë kulturore
12 Shtator, 14:58

Në kërkim për armëmbajtje pa leje dhe prishje të qetësisë, arrestohet në Durrës 50-vjeçari me 2 identitete (EMIRAT)
12 Shtator, 13:45



VIDEO/ Ndërroi jetë pasi ra në kontakt me rrymën elektrike, momenti kur 43-vjeçarin në Durrës e kap korrenti pasi prek shtyllën e ndriçimit
12 Shtator, 11:43

Parandalohet krimi në familje në Krujë, 44-vjeçari në pranga, dhunonte gruan dhe vajzën e mitur së bashku me djalin! Në shtëpi i gjenden armë zjarri
12 Shtator, 09:41

Durrës/ Shkëndijë elektrike në autobusin e linjës së plazhit, ndërhyn zjarrfikësja (VIDEO)
11 Shtator, 15:00

Porto Romano, 'urë' detare mes Shqipërisë e NATO-s! VanHorn: SHBA mbështet ndërtimin e një baze ushtarake detare
Aldo Mustafa
11 Shtator, 14:14

Reshjet/ Përmbytet makina në Durrës, shoferi rrëfen momentet e tmerrit: Isha me familjen, u rrethuam nga uji! Shpëtuam me not (VIDEO)
11 Shtator, 10:05

Durrës/ U mbajt te shtylla e ndriçimit të rrugës, 43-vjeçari humb jetën pasi prek një kabllo elektrik të zhveshur (EMRI+VIDEO)
11 Shtator, 07:37

Rikthehen reshjet e dendura të shiut! Përmbytje në Vlorë dhe Lezhë, problematike situata edhe në Durrës (VIDEO)
11 Shtator, 07:28

Durrës/ Ishte duke u larë në det, mbytet 16-vjeçari
10 Shtator, 20:02

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje